

Eppc Kosovo kërkon një **Specialist i/e Pasurive të Paluajtshme** për një kompani vendore e cila merret me ndërmjetësim në shitblerje dhe qiradhënie të pasurive të paluajtshme.

#### **Përgjegjësitë Kryesore:**

- Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve superiore me klientët;
- Të bëjë kërkim dhe hulumtim ligjor, ekonomik dhe financiar të përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave që lidhen me projekte dhe propozime të ndryshme;
- Promovon shitjen/ qiradhënien e pronave të paluajtshme përmes reklamave, rrjeteve sociale, dhe formave tjera të marketingut;
- Të koordinojë takimet dhe vizitat për blerësit potencial;
- Asiston blerësit gjatë vizitave në prona duke i këshilluar ata për kushtet e ofertës dhe vlerën e pronave;
- Monitoron tregun dhe plotëson listën e pronave (në databazë të kompanisë) që janë të përshtatshme për shitblerje apo qiradhënie;
- Ndhmon ekipin në zhvillimin e strategjisë, dhe menaxhon transaksionet nga fillimi deri në fund.

#### **Kërkesat për këtë pozicion janë:**

- Diplomë universitare (përbën avantazh në degët Ekonomi, Marketing, Juridik, etj.);
- Eksperiencë pune së paku dy vite në shitje dhe në terren;
- Të jetë person energjik, ambicioz dhe i/e disiplinuar në punë;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, prezantimi dhe shitjeje;
- Të ketë njohuri rreth tregut të pasurive të paluajtshme përbën avantazh;
- Njohuri të mira të paketës Microsoft office (Word, Excel, etj.);
- Të posedojë leje drejtimi, kategoria B.

#### **Të dhënat:**

<b>Pozicioni:</b>	Specialist i/e Pasurive të Paluajtshme;
<b>Vendndodhja:</b>	Prishtinë;
<b>Orari:</b>	40 orë në javë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	11.02.2018.

#### **Si të aplikoni:**

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.  
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.